



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT NË FUSHËN
E MINIERAVE DHE INDUSTRIËS**

Nr. 4047 prot.

Tiranë, më 05.07.2019

Lënda: Njoftim për fillim procedurash revokimi të lejes nr.1848, datë 23.10.2017.

SHOQËRISË “TRADE MINERALS AL” SH.P.K
Njësia bashkiake nr.9, Rruga e Barrikadave, Galeri 17 Nëntori, Kati i Dytë,
Ambienti nr.2, Tiranë

Për dijeni: AGJENCISË KOMBËTARE TË BURIMEVE NATYRORE
Blloku “Vasil Shanto”, Nr.18, Tiranë.

AUTORITETIT KOMBËTAR PËR SIGURINË DHE EMERGJENCAT NË MINIERA
Rruga “Lord Bajron”, Laprakë, Tiranë.

Shoqëria “Trade Minerals Al” sh.p.k është zotëruese e lejes minerare të shfrytëzimit nr.1848, datë 23.10.2017, për mineral bakri, në objektin “Shëmëri”, Bashkia Kukës.

Nga struktura përgjegjëse e AKBN-së me shkresën nr.2588, datë 08.04.2019, protokolluar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë me nr.4047, datë 10.04.2019, është propozuar revokimi i lejes nr.1848, datë 23.10.2017, për mineral bakri, në objektin “Shëmëri”, Bashkia Kukës, sepse nuk keni paguar garancinë financiare të rehabilitimit të mjedisit për vitin 2018 - 2019, duke mos respektuar kërkesat e nenit 31 të Ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe akteve nënligjore që kanë dalë në zbatim të tij.

Propozimi i Agjencisë Kombëtare të Burimeve, është i mbështetur në germen “ç” pika 1, të nenit 47, (neni që përcakton shkeljet ligjore për të cilat një leje revokohet), të Ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Sa më sipër, në zbatim të nenit 48, të Ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, **ju njoftojmë fillimin e procedurave të revokimit të lejes minerare të shfrytëzimit nr.1848, datë 23.10.2017, për mineral bakri, në objektin “Shëmëri”, Bashkia Kukës, që shoqëria juaj zotëron.**

Ju bëjmë me dije se, pas një periudhe 30 ditore nga ky njoftim, do të merret vendimi për revokimin e lejes shfrytëzimit nr.1848, datë 23.10.2017, për mineral bakri, në objektin “Shëmëri”, Bashkia Kukës.

Në zbatim të nenit 49, të Ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, duhet të rehabilitoni zonën e shfrytëzimit në të cilën keni ushtruar aktivitet minerar.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin!

MINISTRI
BELINDA BALLUKU
ME AUTORIZIM
ZËVENDËSMINISTRI

